



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija Statistike Kosova – Kosovo Agency of Statistics

Seria 5: Statistikat Sociale

Niveli i pagave në Kosovë 2024





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija Statistike Kosova – Kosovo Agency of Statistics

Seria 5: Statistikat Sociale

Niveli i pagave në Kosovë 2024



Hyrje

Ky raport është hartuar në bazë të kërkesës dhe nevojës nga shfrytëzuesit, përfshirë institucionet shtetërore dhe shfrytëzuesit e ndryshëm. Të dhënat e prezantuara në këtë raport janë të dhëna, që do t'u ndihmojë vendimmarrësve në orientimin e politikave të tyre dhe në planifikimin e mënyrave më efektive në mbajtjen dhe motivimin e punonjësve.

Niveli i pagës është një e dhënë e rëndësishme, jo vetëm për organizatat, që e shfrytëzojnë si bazë për të bërë ndryshime (ritje/ulje), por njëherit është edhe tregues shumë i rëndësishëm për investitorët e rinj dhe çelës apo instrument tërheqës për të marrë kandidatë më të mirë.

Kur një organizatë është e përbërë nga njerëz të aftë dhe të motivuar nuk mungojnë edhe sukseset. Strukturat e pagave janë pjesë e domosdoshme e menaxhimit efektiv por janë edhe faktorë bazë dhe shtytës të zhvillimeve. Për qasje më të lehtë të shfrytëzuesëve, në këtë raport është dhënë paga mesatare bruto dhe neto.

Raporti përmban të dhënat për vitin 2024 derisa janë paraqitur të dhënat edhe për vitet 2020 - 2024 si qasje e vazhdueshme. ASK-ja planifikon që ti publikojë rregullisht të dhënat për pagën mesatare në nivelin më të ulët edhe sipas sektorëve ekonomikë.

Ndarja e nivelit të pagave është bërë për tre (3) sektorët si me poshtë:

- Sektorin Publik (Administrata),
- Sektorin Privat, dhe
- Ndërmarrjet publike

Komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja, lidhur me këtë publikim, janë të mirëseardhura dhe mund të dërgohen në adresën elektronike: infoask@rks-gov.net

Publikimin e përgatitën:

Naime Rexhepi	- Drejtoreshë e Departamentit të Statistikave Sociale
Bujar Hajrizi	- U.d. Udhëheqësi i Divizionit të Statistikave Sociale
Shpetim Bullatovci	- Zyrtar i Tregut të Punës.
Besarta Thaçi	- Zyrtare e tregut të punës
Guxim Neziri	- Zyrtar i TI-së për RSB-s

Drejt看 Ekzekutiv, ASK-së
Avni Kastrati

Shkurtesat

ARBK	Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BRK	Buxheti i Republikës së Kosovës
ISCO	Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Profesioneve
NACE	Klasifikimi Statistikor i Aktiviteteve Ekonomike
RSB	Regjistri Statistikor i Bizneseve
MFPT	Ministria e Financave Punës dhe Transfereve

Hyrje	1
Përmbajtja	6
Definicione.....	7
Burimi i të dhënave dhe metodologjia.....	8
Sektori publik.....	8
Sektori privat	8
Ndërmarrjet publike	8
Niveli i pagës mesatare në Kosovë.....	9
Paga mesatare sipas sektorëve në Kosovë.....	10
Sektori publik.....	10
Ndërmarrjet publike	10
Sektori privat	11
Pagat mesatare bruto sipas sektorëve	11
Paga mesatare neto sipas sektorëve.....	12
Paga minimale në Kosovë	13
Paga mesatare bruto dhe neto sipas aktiviteteve ekonomike	14

Definicione

Paga bruto	Të ardhurat bruto të punonjësve, që përfshinë të ardhurat për punën dhe kohën e kaluar në punë, të ardhurat e tjera personale, të përcaktuara me ligj ose me marrëveshje kolektive (shtesat), ose kontratën e punës, në të cilën tatimi mbi të ardhurat personale është zbatuar. Ndryshe, paga bruto është shuma e përgjithshme e pagës pa tatim dhe pa kontributet e zbritura (pension/kursime pensionale, sigurime shëndetësore, etj.).
Paga neto	Pagat neto janë tatimi dhe kontributet e zbritura nga paga bruto.
Spektori publik	Të gjithë të punësuarit, të cilët marrin pagë nga Buxheti i Republikës së Kosovës janë përfshirë në sektori publik.
Spektori privat	Të gjithë të punësuarit, të cilët punojnë pranë ndërmarrjeve private (bizneset private), për të cilët ndërmarrjet paguajnë taksat dhe kontributet e tyre.
Ndërmarrjet publike	Ndërmarrjet publike përfshijnë të gjitha ndërmarrjet, që janë në pronësi publike, ose janë themeluar me fonde publike, ose sipas ligjit publik dhe nuk janë autoritete publike, ose pjesë të autoriteteve publike.

Burimi i të dhënave dhe metodologjia

Sektori publik

Burimi i të dhënave: të dhënat për sektorin publik janë nxjerrë nga MF/PT Thesari - Divizioni i Administrimit të Pagesave/lista e pagesave të pagave për pagën bruto dhe neto.

Metoda e llogaritjes së pagës mesatare vjetore/sektori publik: Kalkulimi i pagës mesatare vjetore për sektorin publik është bërë sipas formulës:

$$\bar{x} = \frac{\sum_{i=1}^n x_i}{n} = \frac{x_1 + x_2 + \dots + x_n}{n}$$

$\bar{x}$	prezanton simbolin për mesataren aritmetike të mostrës
n	është numri total i vërtetimeve- elementeve
x	prezanton vlerat individuale
Σ	prezanton shumën e përgjithshme të vlerave

Sektori privat

Burimi i të dhënave: për vitin 2024 është Administrata Tatimore e Kosovës derisa në vitet paraprake të dhënat janë nxjerrë nga Regjistri Statistikor i Bizneseve (RSB), që përmban të dhëna për të gjitha ndërmarrjet (publike dhe private), që ushtrojnë aktivitetin ekonomik brenda territorit të Kosovës. Kjo përfshinë të gjithë sektorët ekonomikë sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NACE Rev.2. Nuk përfshinë Administratën Publike, Organizatat Jo-Fitimprurëse dhe Organizatat Ndërkombëtare.

Burimet për azhurnimin e variablave të RSB-së janë: Burimet administrative (informacionet nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë dhe nga Administrata Tatimore e Kosovës), si dhe burimet statistikore (Anketa për Azhurnimin e RSB-së, Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve dhe Anketat për Statistikat Afatshkurtra).

Ndërmarrjet publike

Burimi i të dhënave: për vitin 2024 është Administrata Tatimore e Kosovës derisa në vitet paraprake të dhënat për ndërmarrjet publike janë nxjerrë nga Regjistri Statistikor i Bizneseve (RSB), baza e njëjtë si te sektori privat.

Niveli i pagës mesatare në Kosovë


Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë në Kosovë gjatë vitit 2024 ishte 639 Euro, duke u rritur për 12.1% krahasuar me vitin 2023.

Përderisa paga mesatare mujore neto për një të punësuar me pagë në Kosovë gjatë vitit 2024 ishte 552 Euro, duke u rritur për 9.0% krahasuar me vitin 2023.

Tab. 1: Niveli i pagës mesatare bruto dhe neto (në Euro), sipas viteve 2020 - 2024

Viti	Kosovë		Sektori Publik		Ndërmarrjet Publike		Sektori Privat	
	Bruto	Neto	Bruto	Neto	Bruto	Neto	Bruto	Neto
2020	466	416	624	552	769	680	380	342
2021	484	432	612	542	768	680	419	376
2022	521	446	604	536	789	659	473	401
2023	570	506	713	630	789	691	515	459
2024	639	552	755	668	783	685	598	513

Graf. 1: Paga mesatare bruto dhe neto (në Euro) sipas viteve 2020-2024




Paga mesatare sipas sektorëve në Kosovë

Sektori publik

Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar në sektorin publik në vitin 2024 ishte 755 Euro, duke u rritur për 5.9% krahasuar me vitin 2023.

Ndërsa paga mesatare mujore neto për një të punësuar në sektorin publik ishte 668 Euro duke u rritur për 6.1%.


Graf. 2: Niveli i pagës mesatare bruto dhe neto (në Euro) në sektorin publik, 2020-2024



Ndërmarrjet publike

Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar në Ndërmarrjet Publike në vitin 2024 ishte 783 Euro derisa paga mesatare neto për një të punësuar në Ndërmarrjet Publike ishte 685 Euro.


Graf. 3: Niveli i pagës mesatare bruto dhe neto (në Euro) në ndërmarrjet publike, 2020-2024



Sektori privat

Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar në sektorin privat gjatë vitit 2024 ishte 598 Euro, duke u rritur për 16.1% krahasuar me vitin 2023. Derisa, paga mesatare mujore neto për një të punësuar në sektorin privat ishte 513 Euro duke u rritur për 11.8% krahasuar me vitin 2023.


Graf. 4: Niveli i pagës mesatare bruto dhe neto (në Euro) në sektorin privat, 2020-2024



Pagat mesatare bruto sipas sektorëve

Niveli i pagave më të larta në Kosovë ishte te ndërmarrjet publike. Në vitin 2024 te ndërmarrjet publike, paga mesatare bruto për një të punësuar ishte 783 Euro. Sektori publik, në vitin 2024 kishte një pagë mesatare bruto për një të punësuar 755 Euro. Ndërsa Sektori privat ishte sektori me pagën më të ulët mesatare bruto për një të punësuar me 598 Euro.


Graf. 5: Niveli i pagave mesatare bruto (në Euro) sipas sektorëve, 2020-2024



Paga mesatare neto sipas sektorëve _____

Te ndërmarrjet publike, paga mesatare neto, për një të punësuar në vitin 2024 ishte 685 Euro. Sektori publik, kishte një pagë mesatare neto për një të punësuar prej 668 Euro. Ndërsa sektori privat, kishte një pagë mesatare neto për një të punësuar prej 513 Euro.

Graf. 6: Niveli i pagës mesatare neto (në Euro) sipas sektorëve, 2020-2024



Paga minimale në Kosovë

Norma e pagës minimale është paga më e ulët e lejuar, zakonisht e rregulluar përmes ligjeve shtetërore. Në Kosovë, deri në muajin shtator paga minimale ishte e kategorizuar në 130 Euro për të punësuarit deri në moshën 35-vjeçare dhe 170 Euro për të punësuarit mbi moshën 35-vjeçare derisa prej 1 Tetor 2024, paga minimale bruto në Kosovë është 350 Euro .

Tab. 2: Raporti i pagës minimale me pagën mesatare bruto dhe neto (në Euro) në Kosovë, 2024

Grupmosha	Paga minimale	Bruto (%)	Neto (%)
Deri në moshën 35-vjeçare	130	20.34	23.55
Mbi moshën 35-vjeçare	170	26.60	30.80

Shënim: sipas ligjit në fuqi deri në muajin Shtator 2024

Paga Bruto	Paga minimale	Bruto (%)	Neto (%)
	350	54.77	63.41

Shënim: Nga data 1 Tetor 2024, ka hyrë në fuqi paga minimale.


Paga mesatare bruto dhe neto sipas aktiviteteve ekonomike

Indikator mjaft i rëndësishëm është edhe paga bruto dhe neto sipas aktiviteteve ekonomike në Kosovë. Aktivitetet ekonomike që ofrojnë pagë mesatare mujore më të lartë janë: Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (1105 euro bruto dhe 970 Neto) dhe Informim dhe komunikim (1090 euro bruto dhe 935 Euro neto), derisa paga më e ulët ishte tek Akomodimi dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim (389 euro bruto dhe 331 Euro neto).

Tab. 3: Paga mesatare (në Euro) sipas aktiviteteve ekonomike në Kosovë, 2024

Aktivitetet ekonomike		Paga mesatare	
		Bruto	Neto
A	Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	417	358
B	Xehetari dhe gurëthyes	666	582
C	Prodhim	528	451
D	Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	1105	970
E	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të	657	582
F	Ndërtimtari	560	479
G	Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve dhe motoçikletave	546	466
H	Transporti dhe magazinimi	530	459
I	Akomodimi dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	389	331
J	Informim dhe komunikim	1090	935
K	Aktivitete financiare dhe të sigurimit	670	592
L	Aktivitete të patundshmërisë	571	494
M	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	766	656
N	Aktivitete administrative dhe mbështetëse	764	652
O	Administratë publike dhe mbrojtja, sigurimi social i detyrueshëm	789	697
P	Arsim	617	546
Q	Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	767	669
R	Art, zbavitje dhe rekreacion	610	529
S	Aktivitete të shërbimeve tjera	366	313

Graf 8: Paga mesatare bruto dhe neto (në Euro) sipas aktiviteteve ekonomike, 2024



Rreth Agjencisë së Statistikave të Kosovës

Përshkrim i shkurtër

Historiku i shkurtër - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) është institucion profesional dhe i pavarur që merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare statistikore në nivel kombëtar. E themeluar që nga viti 1948, ASK ka kaluar nëpër faza të ndryshme zhvillimore, duke vepruar në përputhje me strukturat shtetërore të kohës.

Pas një ndërprerjeje në periudhën 1989–1999, ASK rifilloi aktivitetin më 2 gusht 1999 si institucion i pavarur brenda Ministrisë së Administratës Publike. Nga 1 korriku 2020 gati për dy vite të plota, veprimi në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Aktualisht funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Financimi i ASK-së bëhet nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe nga donatorë ndërkombëtarë për projekte specifike dhe ndihmë teknike.

Legjislacioni: ASK vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 për Statistikën Zyrtare dhe ndryshimeve përkatëse përmes Ligjit Nr. 06/L-058. Struktura organizative përfshin Departamente Prodhuese si Departamenti i Statistikave Ekonomike, Departamenti i Llogarive Kombëtare, Departamenti i Statistikave Sociale, Departamenti i Statistikave të Bujqësisë e Mjedisit, Departamentet mbështetëse si Departamenti i Metodologjisë dhe Teknologjisë Informative, Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim, Departamenti i Regjistrimit dhe Anketimit, Departamenti i Administratës. Në kuadër të Agjencisë veprojnë edhe Zyrat Rajonale në: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Gjiçan, Ferizaj dhe Mitrovicë.

Misioni i ASK-së - Të ofrojë të dhëna statistikore cilësore dhe të besueshme për të gjithë përdoruesit – institucione qeveritare, komunitetin akademik, sektorin privat dhe publikun e gjerë – në mbështetje të vendimmarrjes, planifikimit dhe zhvillimit të politikave në të gjitha nivelet.

Objektivi i ASK-së - Të prodhohen dhe shpërndahen të dhënat statistikore në mënyrë sistematike, të besueshme dhe të paanshme. Përfshirë shfrytëzimin profesional dhe standardet etike, d.m.th se politikat dhe praktikën janë transparente për shfrytëzuesit dhe respondentët e anketave.

Vizioni i ASK-së - Të jetë burimi kryesor dhe më i besueshëm i statistikave zyrtare në Kosovë, në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke mbështetur vendimmarrjen, transparencën dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Bashkëpunimet - Agjencia e Statistikave të Kosovës bashkëpunon me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës sidomos me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve si dhe Bankën Qendrore të Kosovës ku edhe përbejnë Sistemin Statistikor të Kosovës. Agjencia ka bashkëpunim të ngushtë edhe me organizata ndërkombëtare si: EUROSTAT, FMN, Banka Botërore, INSTAT, SIDA, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, VIIES, IMF, ILO STAT, UNODC, ETF, IA, OECD si dhe me institucionet statistikore të rajonit.

Gjatë vitit 2024, u realizua me sukses Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë – një projekt kyç për hartimin e politikave zhvillimore të qëndrueshme.

ASK mbulon tërë territorin e Republikës së Kosovës përmes rrjetit të njëjësive raportuese dhe qarqeve statistikore, duke siguruar të dhëna të dorës së parë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Adresa:

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë

Telefoni:

+383 (0) 38 200 31 129

Drejtor Ekzekutiv:

+383 (0) 38 200 31 112

Fax:

+383 (0) 38 235 033

E-mail:

infoask@rks-gov.net

Ueb-faqe:

<http://ask.rks-gov.net>